

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
"ÇABRATI"
SH.A - JSH DD.
Nr. No. B. 1638
D. 31.10.2019



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"


Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova



BIZNES PLANI

2020

Tetor, 2019



1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Plani i Biznesit për vitin 2020, paraqet orientimet e KRM "ÇABRATI" Sh.A, në realizimin e objektivave dhe caqeve të parashtruara brenda këtij viti në mënyrë që të ofrohet një shërbim kualitativ, i vetë qëndrueshëm dhe efektiv i cili do të kënaqë edhe pritjet e konsumatorëve, komunitetit të biznesit dhe institucioneve lokale në regjionin e Gjakovës. Mirëpo, në rrugëtimin e veprimtarisë së kompanisë, do të ndeshemi edhe në sfidat të cilat kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë financiare, krijimin e mjeteve të nevojshme investive, shfrytëzimin maksimal të asetëve dhe burimeve njerëzore, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje menaxhimin dhe deponimin e mbeturinave. Në zbërthimin e mëtutjeshëm të këtij plani janë paraqitur objektivat e shoqëruara me aktivitetet dhe impaktin e pritur e që ndërlidhet me rritjen e përqindjes së inkasimit në lokacionet urbane, zgjerimin e ofrimit të shërbimit nëpër zonat rurale, rritjen e të hyrave përmes ofrimit të kontratave të reja me bizneset dhe amvisëritë. Gjithashtu, bashkëpunimi me Kuvendin e Komunës me pakot tenderuese të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbërimit, investimet në makineri dhe procesin e riciklimit, rritjen e shkallës së arkëtimit të borxheve nëpërmes procedurave përmbarimore e gjyqësore dhe në fund përmirësimi i strategjive komunikuese dhe marrëdhënieve me publikun, do jenë prioritete dhe specifika të cilat do e shoqërojnë këtë plan për vitin vijues. Gjithashtu, në plan përmes një SWOT analize, (Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve), të cilat në një formë e pasqyrojnë një skanim të gjendjes reale në mjedisin ku ndërvepron KRM "ÇABRATI" Sh.A. Njëherit, janë pasqyruar edhe veprimtaritë dhe planet për vitin 2020, për secilin sektor të kompanisë, duke filluar me Operativën, Sektorin e Faturimit, Inkasimit dhe Marrëdhënieve me Konsumatorë, pastaj një kapitull i veçantë i kushtohet punës në Stacionin Transfer dhe procesit të Riciklimit. Në fund janë të paraqitura projeksionet financiare për vitin 2020.

Dokumenti në fjalë është produkt i një interakcioni intensiv dhe gjithë përfshirës i aktorëve dhe hisedarëve të involvuar direkt në punën e KRM "ÇABRATI" Sh.A, duke filluar me stafin menaxhues dhe operativë, anëtarët e Bordit të Drejtorëve, Komisionin Komunal të

Aksionarëve, grupeve të konsumatorëve dhe institucioneve të cilat janë të ndërlidhura direkt më punën e KRM “ÇABRATI” Sh.A.

1.1 Historiku i ndërmarrjes

Kompania Rajonale e Mbeturinave ekziston që nga viti 1951. Fillimisht si Enti për pastrimin e qytetit me emrin “ERENIKU”, pastaj nga viti 1971 si organizatë komunale me emrin e tanishëm K.R.M. “ÇABRATI” Sh.A., veprimtaria kryesore e të cilës ishte grumbullimi dhe bartja e mbeturinave. Gjatë periudhës së operimit kompania pësoj ndryshime të mëdha si në formë të organizimit ashtu edhe në shërbimet e ofruara. Pas luftës edhe përkundër humbjeve dhe dëmeve të pësuar, arriti të rimëkëmbet dhe shumë shpejt të jetë në shërbim të qytetarëve të Gjakovës. Kompania funksionon si shoqëri aksionare me emër KRM “Çabrati” Sh.A. Gjakovë, prej vitit 2008. Pronare e KRM “Çabrati” SH.A. është Komuna (me 100% të aksioneve) e organizuar përmes trupave mbikëqyrës dhe udhëheqës të kompanisë: Komisioni Komunal i Aksionarëve, Bordi Drejtorëve dhe Stafit Menaxhues. Veprimtaria vazhdon të ushtrohet kryesisht me vetë financim dhe kontrata me Komunën. Selia e Ndërmarrjes është e ndarë në dy njësi: Njësia Qendrore - drejtoria në rrugën “Mazllom Lakuci” dhe Njësia Teknike-Operative, e cila ndodhet në objekti i policisë së vjetër. Përpos selisë qendrore dhe operative kemi në shfrytëzim me të drejtë ligjore edhe objektin e varrezave të qytetit.

1.2 Veprimtaria

KRM “ÇABRATI” Sh.A, me Statutin e Ndërmarrjes Publike, si sfidë ka inkorporimin në bazë të kërkesave reale të tregut dhe ballafaqimin me konkurrencën e barabartë me kompanitë tjera private dhe publike. Derisa, kompania është e angazhuar në kryerjen e punëve ditore të cilat në njëfarë forme janë edhe punë rutinore, konsumatorët/klientët tani kërkojnë kualitet, siguri dhe shërbim kualitativ. Prandaj, funksionaliteti i ofrimit të shërbimeve adekuate dhe në kohë reale duhet të jetë në harmoni dhe i ekuilibruar me kërkesat e tregut dhe mundësitë dhe potencialet e kompanisë. KRM “ÇABRATI” Sh.A., mbanë pjesën operacionale të menaxhimit të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta, komunale përbrenda kufijve administrative të

komunës së Gjakovës. Kompania “ÇABRATI” Sh.A. është në pronësi të Komunës, si aksionare kryesore dhe statuti i kësaj kompanie është – Kompania Regjionale e Mbeturinave (K.R.M) “ÇABRATI” Sh.A. Kompania ofron tri lloje të shërbimeve: konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset e mëdha dhe ato të vogla, si dhe institucionet lokale, (shkollat, spitalet, muzetë, entet, ndërmarrjet publike etj).

Konsumatorët e amvisërive ndahen në dy kategori, në ato që e pranojnë shërbimin derë më derë dhe ato të cilat janë të pajisur me kontejnerë kolektiv. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë 1.1m³ apo 240l. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve, ndonjë zyre të vogël të OJQ-ve, avokatie apo të ngjashme zakonisht janë me kontrata të veçanta dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë. Intervali kohorë i mbledhjes së mbeturinave është zakonisht nga ora 07:30 – 15:30.

Ndërsa nga viti 2019 sipas planit të ri operativ, konsumatorëve nga rrugët kryesore të qytetit u ofrohen shërbimet duke filluar nga ora 19:00 e mbrëmjes, ky shërbim ofrohet dy herë.

1.3 Aktivitetet primare dhe sekondare

Veprimtaria kryesore e KRM “Çabrati” SH.A., është grumbullimi dhe bartja e mbeturinave në regjionin e Gjakovës për klientët tanë që janë amvisëritë, bizneset dhe institucionet.

Tani për tani kompania jonë si aktivitete sekondare përfshinë:

- Pastrimin e rrugëve dhe pjesën e Lumit Krena – pjesa e ndërtuar;
- Menaxhimin e varrezave dhe shërbimet e varrimit;
- Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe mbjelljen e fidanëve.

KRM“Çabrati” Sh.A., për këto aktivitete sekondare, nënshkruan kontrata afat-shkurtëra (zakonisht për ca muaj apo vjetore) me komunën dhe kompanitë private.

2. VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET E KOMPANISË

2.1 Vizioni

Për një qytet të pastër me shërbime kualitative dhe në kohë reale, qytetarë të kënaqur me këto shërbime dhe mbulueshmëri në tërë regjionin e Gjakovës. Po ashtu, kompania synon të jetë edhe aktor strategjik për komunën në përpunim dhe ndarjen në burim të mbeturinave të riciklueshme projekt ky që pritet të filloj në vitin 2020.

2.2 Misioni

Ofrimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë banorët e regjionit të Gjakovës, pa dallime fetare, racore, gjinore dhe gjeografike. Sigurimin e vetë qëndrueshmërisë financiare dhe orientimin e shërbimeve me praktikatat më të mira ndërkombëtare të kompanive publike.

2.3 Qëllimet e kompanisë

Qëllimet e KRM"Çabрати" Sh.A., janë ofrimi i mbledhjes së mbeturinave, pastrimit të qytetit, ofrimit të shërbimeve mortore dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit, të gjitha me qëllim të përbashkët: ruajtjen e ambientit dhe ofrimin e shërbimeve kualitative për qytetarët e regjionit të Gjakovës.

Pra në përgjithësi janë këto qëllime që duhet të arrihen nëpërmes:

- Forcimit të kapaciteteve të KRM"Çabрати" Sh.A., që të rrisë kualitetin e shërbimeve, (paisjen me mekanizim dhe automjete, etj.);
- Modernizmin e sistemit të financave dhe kontabilitetit me anë të programeve të reja të cilat do ta rrisin cilësinë dhe kualitetin e shërbimeve të faturimit dhe inkasimit;
- Përmirësimin e kapaciteteve të personelit nëpërmes ngritjes profesionale dhe avancimin e tyre në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave të qytetarëve;
- Zgjerimin e bazës së konsumatorëve dhe ofrimin e kontratave të reja për ta, nga të tri kategoritë: amvisëritë, bizneset dhe institucionet;
- Kontaktin me përfaqësues të fshatrave lidhur me ofrimin e shërbimeve tona dhe zgjerimin e shërbimeve tona edhe nëpër fshatra ku nuk ofrojmë shërbim;

- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet komunale lokale, (Drejtorinë e Inspektionit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtoritë tjera), në mbarëvajtjen dhe ecurinë e shërbimeve tona;
- Bashkëpunimin dhe përfaqësimin në Gjykatat e rregullta dhe Përmbaruesin Privat për zgjidhjen e problemeve të borxheve. Respektimin e procedurave për arkëtimin e këtyre borxheve;
- Kooperimin dhe zhvillimin e projekt-iniciativave të cilat do të forcojnë kapacitetet e KRM "Çabрати" Sh.A., përmes marrjes së donacioneve dhe përkrahjes financiare nga agjencitë dhe organizatat të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë;
- Inkurajimin e bashkëpunimit në mes të KRM "Çabрати" Sh.A., dhe kompanive si motra të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë;

2.4 Objektivat

Objektivat e synuara të kompanisë janë rritja e kualitetit të shërbimeve, rritje të inkasimit dhe zgjerimit të rrjetit shërbyes në zonat rurale. Sfidë për të ardhmen mbetet kategorizimi bizneseve dhe inkasimit në bashkëpunim të koordinuar me drejtoritë përkatëse të Kuvendit Komunal. Në tabelën e poshtme janë paraqitur objektivat e kompanisë, aktivitetet që duhet ndërmarr për arritjen e tyre si dhe impakti i tyre:

Objektivat	Aktivitetet	Impakti
1. Rritja e përqindjes së inkasimit në lokacionet urbane.	<p>1.1 Përmirësimin e inkasimit në terren dhe ri organizmin e terrenit.</p> <p>1.2 Forcimin e kapaciteteve të Kontrollës së brendshme në mbulimin e terrenit dhe identifikimin e problemeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e potencialit për ofrimin e shërbimeve nëpërmes inkasimit efikas në zonat ku ofrohen shërbimet, • Rritja e kërkesës për shërbime dhe shkallës së të hyrave të faturuara.

<p>2. Zgjerimi i ofrimit të shërbimit nëpër zonat rurale dhe rritjen e përqindjes së inkasimit nëpër ato zona ku vetëm jemi duke ofruar shërbime.</p>	<p>2.1 Regjistrimet e reja nëpër fshatra tek amvisërit/ bizneset dhe ofrimin e shërbimeve në baza të rregullta.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbulimi me shërbime për konsumatorët e regjistruar në zonat rurale.
<p>3.Regjistrimin e amvisërive në zonat rurale ku Ndërmarrja ofron shërbim (Zgjerimi me planin e ri Operativ).</p>	<p>3.1. Zgjerimi i shërbimit mbi 3000 amvisërive në zonat rurale dhe regjistrimi i tyre në sistemin e shërbimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e vlerës së faturimit dhe inkasimit (të hyrat e Ndërmarrjes).
<p>4.Rritja e të hyrave përmes evidentimit dhe përditësimit të dhënave dhe zyrës për konsumatorë.</p>	<p>4.1 Forcimin e kapacitetve të personelit në përdorimin e softërit të ri në lidhje me Bazën e të Dhënave për Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Rritjen e performances dhe llogaridhënies në lidhje me ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve.
<p>5.Rritja e të hyrave nëpërmes të ofrimit të kontratave të reja me bizneset dhe amvisëritë.</p>	<p>5.1. Përmirësimin e performances së inkasantëve, stafit menaxhues në lidhje me kontratat e reja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Rritjen e vetëdijës së qytetarëve në lidhje me shërbimin e mbeturinave.
<p>6. Përcaktimi I tarifave fikse për ekonomitë familjare jo rezidente dhe rezidente, si dhe bizneset e vogla.</p>	<p>6.1. Kërkesë Kuvendit Komunal si organ për përcaktimin e tarifave (cmimin e faturës).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria financiare e Ndërmarrjes;
<p>7. Rritja e të hyrave nga pakot tenderuese nga Kuvendit Komunal (tenderin e gjelbërimit).</p>	<p>7.1 Aplikimin dhe përgatitjen e tenderit për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese dhe pastrimin e rrugëve të shpallur nga Kuvendi Komunal.</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Forcimin e kapaciteteve të KRM “ÇABRATI” mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe gjelbërimin tyre.
<p>8. Investimet në modernizimin e ofrimit të shërbimit me konsumatorë,</p>	<p>8.1 Aplikimin e teknologjive të reja me Softëer, (për faturim, inkasim dhe prokurim dhe marrëdhënie me konsumatorë).</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Modernizimin dhe digjitalizimin e ndërmarrjes në ofrimin e shërbimeve për konsumatorë,

<p>9. Investimet në automjete dhe mekanizëm të punëve operative.</p>	<p>9.1 Marrjen e 3 kamionëve nga projekti i GIZ / MZHE - "Tambajmë Kosovën e Pastër"; 9.2 Marrjen e 3 kamionëve nga Gara për Mjedis të pastër 2; Blerjen e 2 kamionëve me mjete vetanake nga KRM "ÇABRATI"; 9.3 Marrjen e 200 dhe shprëndarjen e kontenjerëve 1.1 m3 nga fondet e BE-së dhe GIZ-it.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e potencialit dhe mundësive të KRM "ÇABRATI", në ofrimin e shërbimeve kualitative dhe në kohë reale në tërë regionin e Gjakovës. • Krijimin e logjistikës dhe hapësirave të nevojshme për bartjen e mbeturinave.
<p>10. Përfshirje në Biznesin e Riciklimit</p>	<p>10.1. Implementimi i projektit nga Fondet e IPA 2014 - 2020, në bashkëpunimin ndërkufitar Mali I Zi / Kosovë; 10.2 Trajnimi i stafit në riciklim; 10.3. Menaxhimi i Kopshtit Reciklues në STM.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e ndërgjegjësimit të publikut për riciklim dhe rritje e sasisë së materialeve të riciklueshme • Të hyra shtesë/ zvogëlim i kostos (se paku kostos për KMDK) • Rritje e punësimit / ruajtje e vendeve të punës.
<p>11. Ngritja e efikasitetit të stafit</p>	<p>11.1 Ngritja e kapaciteteve njerëzore operative, administrative dhe menaxheriale (Trajnime profesionale); 11.2 Ndarja e detyrave të punëve dhe përgjegjësi .</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e të hyrave nga përmirësimi i shërbimeve; • Respektimi i hierarkisë vertikale të vendimarrjes dhe forcimin e frymës ekipore në mes stafit.
<p>12. Obligimet e pa arkëtuara - të ndara në muaj / arritja e shkallës së arkëtimit mujor prej 80% dhe arkëtim prej 95% e të të hyrave në total.</p>	<p>12.1 Kontrata dhe ri-programimi i borxheve me klientët; 12.2 Kërkueshmëria e kredisë përmes procedurave ligjore - përmbaruesit privat;</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e performancës dhe vendosja e rregullit për konsumatorët e rinj;

SWOT Analiza e KRM "ÇABRATI" Sh.A.

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Traditë dhe përvojë në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave; • Konsumatorët nga tri kategoritë të kënaqur me shërbimet; • Personeli/stafi ka përvojë në organizimin e punëve operative dhe mbulimin cilësor të terrenit; • Kapacitetet e nevojshme në mekanizëm dhe automjete për ofrimin e shërbimeve në regjionin e Gjakovës; • Kompani e licencuar nga Ministria e Planifikimit dhe Zhvillimit Hapsinorë deri me 2023, për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave; • Kontrata dhe bashkëpunim të qëndrueshëm më Kuvendin Komunal Gjakovës; • Kooperim dhe koordinim me rrjetin PAMKOS, dhe Institucionet tjera; • Staf profesional për përgaditjen e projekteve për kërkim të donacioneve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli dhe shkalla e inkasimit nëpër banesa kolektive dhe fshatra; • Borxhe të akumuluar në të kaluarën; • Zgjerimi në zonat rurale dhe rritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimit; • Forcimin e kapaciteteve të stafit në përdorimin dhe aplikimin e teknologjive të reja; • Investime në makineri dhe paisje për ofrimin e shërbimeve më kualitative; • Mos definimi i menaxhimit dhe funksionalitetit të Stacionit Transfer; • Strategji dhe plane për promovimin dhe performance me publikun; <p>Mungesa e objektit të autoparkut sipas standarteve.</p>

MUNDËSITË

- Regjistrimin e konsumatorëve të rinj (amvisëri, biznese dhe institucione) dhe zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale ku ndërmarrja nuk ofron shërbim;
- Rritjen e inkasimit dhe marrëdhënieve me konsumatorë;
- Rritjen e mundësive për investime të reja kapitale dhe paisjeve;
- Inicimin e procesit të riciklimit dhe ndërtimin e vijave recikluese;
- Forcimin e partneriteti dhe kooperimit me rrjetin PAMKOS dhe ndërmarrjet simotra për mbeturina në Kosovë.

RREZIQET

- Stacioni Transfer;
- Efektiviteti i Komunës në përkrahjen e punës së KRM "ÇABRATI", në mbrojtjen e mjedisit;
- Pastrimi i deponive ilegale dhe menaxhimi i tyre;
- Pranimi i fondeve të fituara (përkrahja financiare nga donatorët dhe qeveria), në kohë reale në mënyrë që të përmbushen objektivat e përcaktuara të kompanisë.

Harta e Komunës së Gjakovës e ndarë në 4 zona për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave



3. Sektori i Operativës

Sektori i Operativës gjatë vitit 2020, do të maksimizojë përpjekjet për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative të grumbullimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Gjakovës. Për të arritur caqet dhe objektivat e përcaktura, sektori duhet të minimizojë shpenzimet dhe të krijojë reforma që ndërlidhen me:

- Përmirësimin e funksionimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave përmes modernizimit të paisjeve dhe mekanizmit teknik, (kamionët e rinjë, vijat e reja të riciklimit, marrja e kontenjerëve të rinjë);
- Inicimin e debatit nëpërmes Komisionit Komunal i Aksionerëve, (KKA), Bordit të Drejtorëve (BD), Stafit Menaxherial, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Institucioneve Lokale të Gjakovës, për Lokacionin e Ri të Operativës, duke marrë parasysh se operimi i tanishëm në objekt të vjetër dhe në pronësi të pa definuar ende nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit;
- Përcaktimin e indikatorëve në lidhje me performancën e personelit operativ dhe atij menaxhues;
- Aplikimin e masave stimuluese për personelin i cili ka një performance të mirë.

3.1 Paisjet / Makineritë – Operativa për momentin disponon me infrastrukturën e saj grumbulluese dhe atë transportuese e cila përbehet nga:

- 5 Kamionë kompaktor me kapacitet 7 ton;
- 5 Kamionë kompaktorë me kapacitet 5 ton;
- 1 Kamionë vetëngarkues me kapacitet 7 ton;
- 2 Kamionë me rimorkio me kapacitet 28 ton për transferimin e mbeturinave deri tek deponia;
- 2 Eskavatorë – Skipi dhe Ulta ngarkuese;
- 1 Autofshesë;
- 2 Kamionë cisternë;
- 3 Traktorë me rimorkio;
- 1 Goldon;
- 1 Veturë e kufomave;
- 1 Veturë e llojit Passat.

Njëherit, qëndrueshmëria e kompanisë sonë është realisht e ndërlidhur me krijimin e mundësive dhe potencialeve të cilat kanë të bëjnë me zgjerimin e bazës së makinerisë dhe paisjeve të tjera të cilat kanë si qëllim përmirësimin e kualitetit të shërbimeve. Duke respektuar

standardin “çdo 6–12 vjet duhet të zëvendësohen kamionët “, planifikimet për vitin vijues kanë të bëjnë me:

- Donacionin nga KVF/GIZ për 3 (tre) kamionët në kuadër të projektit “Gara për Mjedis të Pastër”, si instrument i dobishëm për përmirësimin e performances së mbulimit më shërbim dhe shkallës së inkasimit;
- Donacionin nga GIZ për 3 (tre) kamionë në kuadër të projektit “Gara për Mjedis të Pastër II”.
- Planifikohet të investohet në makineri edhe vlera e shumës së fituar nga MMPH në kuadër të projektit “Ta pastrojmë Kosovën “ me vlerë 150.000 Euro.
- Pergaditjen e projekt aplikacioneve për Zyrën Japoneze në përkrahjen e KRM “ÇABRATI” Sh.A., me kamionë;
- Blerjen e kamionëve me mjete vetanake dhe makinerive tjera;
- Donacioni për paisjet teknike në linjat e riciklimit në kuadër të Programit IPA 2014–2020 të Bashkimit Europian projekti me titull “Iniciativat e Përbashkëta Ndërkufitare për një Menaxhim më të mirë të Mbeturinave”.

LLOJET E AUTOMJETEVE NË AUTO-PARKUN E KRM “ÇABRATI” SH.A.

AUTOMJETI	NR. I SHASISË	TABELA	REGJISTRIMI VLEN DERI ME	AKUM. TE RI ME FLETË GARANCION
IVECO	ËJMA1VPU00CO94329	07-296-BN	04.12.2019	2 copë , 145 Ah. dt. 17.11.2016
IVECO	ËJMA1VPU00CO93915	07-297-BN	29.11.2019	2 copë , 145 Ah. dt. 19.02.2019
IVECO	ËJMA1VPU00CD94251	07-865-AG	24.05.2020	2 copë , 135 Ah. dt. 03.03.2018
MERCEDES AUTONGARKUES	ËDB65213715739797	07-952-BK	29.11.2019	2 copë , 143 Ah. dt. 16.11.2016
MERCEDES 2aks	ËDB61703415322821	07-893-AG	24.05.2020	2 copë , 140 Ah. dt. 07.11.2018
MERC. VITO I KUFOMAVE	VSA63806413154742	07-943-BK	04.12.2019	
FORD	NM0K49TEDDAP77440	07-892-AG	16.08.2020	2 copë , 145 Ah. dt. 19.09.2018
MAN-H18 I BARDH	ËMAH18ZZ35M404834	07-144-DD	20.06.2019	2 copë , 145 Ah. dt. 24.12.2018
MAN	ËMAF09C962M180146	07-356-DC	22.10.2019	2 copë , 145 Ah. dt. 26.01.2016
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001292	07-874-AN	18.07.2020	2 copë, 75 Ah. Dt.03.09.2019
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001337	07-324-BE	03.09.2020	2 copë, 95 Ah. dt. 03.09.2019
HYUNDAI Jashte Perdorimi	KMFGA17HEB0001346	07-349-BE	30.08.2019	2 copë, 100 Ah. dt. 26.01.2019
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001291	07-865-AN	18.07.2020	
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001173	07-873-AN	18.07.2020	2 copë, 100 Ah. dt. 30.07.2016
SKIP	31031454	07-149-VA	03.04.2019	2 copë, 100 Ah. dt. 26.01.2019
ULTA	Y0808012YH0808011	NUK KA	PA LEJE QARKULLIMI	2 copë, 100 Ah. dt. 04.05.2017

TRAKTOR IMT	546398	07-113-VA	02.10.2019	1 copë, 95 Ah. dt. 03.09.2019
TRAKTOR IMT	501303468	07-112-VA	02.10.2019	1 copë, 100 Ah. dt. 05.12.2018
MERC.CISTERN SPERKATESE	ËDB61702415477803	07-894-CO	08.05.2020	2 copë, 100 Ah. dt. 19.04.2019
MERC.CISTERNA FEKALE	38011314814175	07-683-CO	11.01.2019	
MERCEDES KOMPAKT. 1017	38011315124203	07-671-DF	08.05.2020	2 copë, 100 Ah. Dt.14.05.2019
PASSAT	VËVVZZZ3BZXE425617	07-891-AG	24.05.2020	1 copë, 100 Ah. dt. 05.11.2018
TARKTOR IMT	53303101	0938-KS	PA LEJE QARKULLIMI	
AUTO FSHISA	3232	07-429-DD	06.02.2020	
GOLDON	01-10-4-12-0102	NUK KA	PA LEJE QARKULLIMI	

Planifikimet për investime në Paisje

Nr.	Investimet	2020
1.	3 Kamionët - KVF / GIZ (Gara Mjedis Pastër I)	189.083.00 €
2.	3 Kamionët - GIZ (Gara Mjedis Pastër II)	188.000.00 €
3.	2 Kamionë MMPH "Ta pastrojmë Kosovën" 2019	150.000.00 €
4.	1 Kamionë - MZHE / Zyra Japoneze	70.000.00 €
5.	Kontenjerë - 1.1 m3 (Bashkimi European)	30.000.00 €
6.	Transportuesi i selektiveve dytësore (Bashkimi European)	35.000.00 €
7.	Shtypëset Vertikale (Bashkimi European)	12.000.00 €
8.	Transportuesi Manual (Bashkimi European)	400.00 €
9.	Shportat Plastike 120 l (Bashkimi European)	1.000.00 €
10.	Qese për Mbledhjen e Mbeturinave (Bashkimi European)	16.000.00 €
11.	Kamionë Kompaktorë të përdorur	25.000.00 €

	(Mjete Vetanake)	
12.	Paisje Debllokimi i pusetave atmosferike të përdorur (Mjete Vetanake)	10.000.00 €
13.	Një Pick - Up të përdorur (Mjete Vetanake)	6.000.00 €
14.	1 Kamionë transportues MULTI LIFT (kipper) të përdorur (Mjete Vetanake)	35.000.00 €
15.	1 Kompaktor të përdorur 5Ton	6.500.00 €
	TOTAL	762.983.00 €

Shënim: Planifikimi për investimet e parapara për vitin 2020, nga mjetet vetanake, do të ndahen në periudha tremujore të planifikuara si në vijim:

1. Në Tremujorin e parë - TM1, është planifikuar blerja e 1 (një) Pick-Up të përdorur, me vlerë deri në 6,000.00 €, si dhe 1 (një) Kompaktor të përdorur 5 Ton, me vlerë deri në 6,500.00 €.
2. Në Tremujorin e dytë - TM2, është planifikuar blerja e 1 (një) Kamioni Transportues MULTI LIFT (kipper) të përdorur me vlerë deri në 35,000.00 €.
3. Në tremujorin e tretë - TM3, është planifikuar blerja e 1 (një) Kamioni Kompaktorë të përdorur me vlerë deri në 25.000.00 €.
4. Në tremujorin e katërt - TM4, është planifikuar blerja e 1 (një) Paisje Debllokimi i pusetave atmosferike të përdorur, me vlerë deri në 10,000.00 €.

3.2. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe karburanteve

Kontrollimi sistematik dhe mirëmbajtja e automjetve dhe paisjeve tjera teknike të auto parkut të operativës kanë një rendësi specifike. Duke marrë parasysh, makinerinë tonë e cila është e vjetruar dhe ka një shkallë relative të amortizimit, dinamikën e angazhimit të tyre në kryerjen e punëve të përditshme sipas planit operativ të bartjes së mbeturinave, duke shtuar këtu edhe gjendjen në infrastrukturën rrugore, atëherë shpenzimet e mirëmbajtjes duhet të alokohen në baza të rregullta. Kjo ngërthen aplikimin e procedurave të rregullta që kanë të bëjnë me kontrollet: ditore, javore për 10,000 km dhe çdo 20,000 km, pra ne do të "shpenzojmë sot që të

kursejmë nesër”. Ne planifikojmë që pajisjet tona teknike t’i mirëmbajmë dhe riparojmë në punëtorin tonë.

Ne kemi minimizuar shpenzimet tona operative, posaçërisht shpenzimet që kanë të bëjnë me karburantet. Ne përdorim “Ditarin e Automjetit”, për të kontrolluar në mënyrë të dyfishtë shpenzimet e karburantit. Në të ardhmen ne planifikojmë që t’i zvogëlojmë dhe t’i mbajmë nën kontrollë shpenzimet e karburantit.

4. STACIONI TRANSFER

Stacioni Transfer është një komponent kyq i transportit të mbeturinave me kosto efektive. Duke transferuar mbeturinat me automjete lokale, kostoja e bartjes dhe deponimit do të reduktohet ndjeshëm, duke lejuar që mjetet dhe ekipet mobile t’i kushtohen aktiviteteve tjera në grumbullimin e mbeturinave. Gjithashtu, hapësirat e Stacionit Transfer mundësojnë që të kursehet karburanti, përmirëson sigurinë në deponi dhe njëherit mundëson që të krijohen hapësirat e nisjes së procesit të riciklimit dhe instalimin e vijave ricikluese.

Stacioni Transfer në momentin e përgatitjes së këtij dokumenti ende nuk është definuar se në menaxhim të kujt është. KRM “ÇABRATI” Sh.A., është në negociata me autoritetet komunale për të qartësuar pozicionin e tij dhe definimin e menaxhimit të tij, në mënyrë që të vazhdojë më aktivitetet e rregullta të cilat në mënyrë direkte e targetojnë këte hapësirë. Në rrethana të rregullta, KRM “ÇABRATI” Sh.A., në Stacionin Transfer ka të punësuar tre punëtorë, (një vozitës kamioni dhe një punëtorë dhe një shofer për ultë). Ndërmarrja ka burime njerëzore të mjaftueshme në rast të aktivizimit të projektit të BE për kopshtin riciklues. Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët grumbullohen në Stacionin Transfer, ku nga aty ringarkohen në kontenjerë të mëdhenj (25-28 ton) dhe përfundimisht shkarkohen në deponinë sanitare në Landovicë, që menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) – Prishtinë. Pagesa/taksa e deponimit permanent bëhet tek Deponia Sanitare në Landovicë, ku edhe bëhet matja përkatëse. Parashikimet për vitin 2020, janë që së pari të bëhet pastrimi total i hapësirave të Stacionit Transfer. Për këtë problematikë kemi dorëzuar projekt-propozime tek Ministria e Zhvillimit Ekonomike, Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe

donatorët të cilët veprojnë në Kosovë e më gjerë, ku kemi marrë premtime nga MMPH për ndarje të mjeteve në vlerë prej 600.000.00 Euro për pastrimin e Stacionit Transfer, ku në bazë të vlerësimit të sasisë së mbeturinave që janë të grumbulluara në ST janë mbi 60 mijë tonë mbeturina.

5. RICIKLIMI

Komuna e Gjakovës për momentin, nuk ka ndonjë sistem të menaxhimit të mbeturinave. Aktualisht, janë duke mbledhur, transportuar dhe depozituar mbeturinat e përziera, pa asnjë trajtim.

Koncepti i tillë kërkon paisje shtesë teknike të kompanive komunale të shërbimeve komunale. Në vitin 2020, KRM "ÇABRATI" Sh.A., planifikon të involvohet në procesin e riciklimit duke krijuar oborret/linjat e riciklimit për asgjësim dhe trajtimin dytësor të pjesëve të thata të mbeturinave. Ky lokacion do të shërbejë për përzgjedhjen shtesë të mbeturinave të deponuara, paketimin e tyre dhe dërgimin e mëtutjeshëm në treg. Në këtë mënyrë, sasia e mbeturinave të deponuara do të zvogëlohet ndjeshëm, do të sigurohen burime shtesë financiare për funksionimin e kompanive të shërbimeve publike dhe do të rritet niveli i pastërtisë dhe mirëmbajtjes në komunë. KRM "ÇABRATI" Sh.A., ka aplikuar me projektin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes të Malit të Zi dhe Kosovës, në kuadër të Programit IPA 2014–2020 të Bashkimit Evropian. Sëbashku më partnerin nga kompania "Veprimtaritë Komunale" – Plavë/Mali i Zi, është nënshkruar kontrata "Iniciativat e Përbashkëta Ndërkufitare për një Menaxhim me të Mirë të Mbeturinave". Qëllimi i projektit është krijimi i kushteve për një menaxhim të integruar të mbeturinave në komunën e Gjakovës, (Kosovë) dhe Plavës (Mal i Zi). Si aktivitete të rregullta të projektit do të zhvillohet plani për krijimin dhe funksionalizimin e një oborri të riciklimit me 10 pika të riciklimit. Sipas KRM "ÇABRATI" Sh.A., pika kryesore e riciklimit do të ishte Stacioni i Transferimit, i cili është një pikë referimi për të gjitha pikat e riciklimit. Pikat e mbetura mund të krijohen në periferi të lagjeve të mëdha, bizneseve të mëdha dhe banesave kolektive. Në përgjithësi kemi të shënjestruara pikat kryesore që mund të krijohen nga pikat e riciklimit.

- Veprimtaria e ardhme paraqet zhvillimin e procesit të prokurimit dhe blerjen e pajisjeve që lidhen me vendosjen e pikave të riciklimit si presat vertikale për ballimin e mbetjeve sekondare të përzgjedhura dhe për përgaditjen e mbeturinave për shpërndarje të mëtejshme tek ricikluesit;
- mbajtësit e paletave të dorës për heqjen, manipulimin dhe ngarkimin e ballave;
- 1.1m³ kontejnerë që vendosen në pikat e riciklimit në pjesët urbane të komunave për pranimin e mbetjeve të përzgjedhura nga qytetarët dhe në oborrin e riciklimit për pranimin e mbetjeve pas zgjedhjes së përfunduar;
- kontenjerë prej 120 l për manipulimin e fraksioneve të mbeturinave të përzgjedhura në oborrin e riciklimit;
- qese PVC të cilat do t'u shpërndahen banorëve për zgjedhjen e fraksionit të mbeturinave të thata.

6. SEKTORI PËR INKASIM / FATURIM DHE MARRËDHËNIE ME KONSUMATORË

Konsumatorët e amvisërive ndahen në dy kategori në ato që e pranojnë shërbimin derë më derë dhe ata që shërbimi i'u ofrohet me kontenjerë kolektivë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontenjerë 1.1m³ apo 240 l. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve, ndonjë zyrë të vogël të OJQ-ve, të cilave shërbimi i'u ofrohet me kontenjerë 1.1m³.

Intervali kohor i mbledhjes së mbeturinave është zakonisht nga ora 07:30 – 15:30. Ndërsa nga viti 2019 konsumatorëve nga rrugët kryesore të qytetit u ofrohen shërbimet duke filluar nga ora 19:00 si dhe herën e dytë nga ora 22:00. Në kuadër të planifikimit për vitin 2020, KRM “ÇABRATI”, mëton që të rrisë kapacitetin e shërbimeve si në zonat urbane dhe ato rurale.

Përmbrnda vitit 2020, Sektori për Inkasim/Faturim dhe Marrëdhënie me Konsumatorë do të vazhdojë me përgaditjen e faturave për konsumatorët dhe institucionet dhe shpërndarjen e tyre nëpërmes inkasantëve dhe personelit të angazhuar në kompani.

Pagesat e faturave realizohen në sportelet e KRM "ÇABRATI" Sh.A., duke filluar nga ora 08:00-16:00 (e Hënë - e Premte), si dhe nga ora 09:00 - 14:00 (e Shtunë). Njëherit, do të vazhdohet me pranimin e pagesave nëpërmes PTK-së. Raportet javore nga PTK dorëzohen në e-mailin zyrtar dhe në të paraqiten pagesat që konsumatorët i kryejnë në baza javore në KRM "ÇABRATI" Sh.A.

Sipas të dhënave të fundit (deri me datë 31.10.2019), të cilat janë të përditësuara nga KRM "Çabрати" Sh.A., klientët e saj përfshijnë:

- 14,616 klientë të amvisërisë (prej tyre 12,187 aktive, ndërsa 2,429 pasive),
- 3,209 klientë të bizneseve (2,323 aktive, ndërsa 886 pasive).

Nr. R	Amvisëri	AKTIVE	PASIVE
1.	14,616	12,187	2,429
	Biznese	AKTIVE	PASIVE
2.	3,209	2,323	886
TOTAL	17,825	14,510	3,315

6.1. Zgjerimet në zonat rurale

Qëllimi i KRM "Çabрати" Sh.A., është zgjerimi i veprimtarisë në fshatrat e Komunës së Gjakovës, pengimin e hudhjes së mbeturinave rreth fshatrave dhe lumenjve, pengimin e krijimit të deponive të egra, pengimin e mëtutjeshëm të ndotjes së sipërfaqes së tokës e cila rrezikon shëndetin e banorëve të këtyre fshatrave të komunës sonë. Komuniteti i zonave rurale i Komunës sonë çdo ditë që nga pas lufta përballet me këtë problem dhe zgjidhjet që kanë bërë për largimin e mbeturinave kanë qenë jo të mira (hudhja e mbeturinave në lumenjë që ka bërë që niveli i ndotjes së lumnjeve të jetë i lartë, hapja e gropave dhe futja e mbeturinave në to, ka bërë që të lirohen gazra helmues në ajër - është bërë ndotja e ajrit dhe njëkohsisht edhe e tokës

gjë që ndikon në prodhime bujqësore të dëmshme për jetën e njeriut). Pra qëllimi është të kemi ambient të pastër, ekologjik dhe shëndet të mirë të banorëve të komunitetit.

Në vitin 2017 (bazuar në të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës - Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017), në zonat rurale të komunes së Gjakovës jetojnë 53.729 banorë, prej tyre 39.969 shërbehen nga KRM "ÇABRATI" Sh.A., që do të thotë se shprehur në përqindje kjo është 74 %. Duke marrë parasysh kërkesat në rritje të konsumatorëve nga viset rurale, deri më tani kemi ofruar shërbimet në 61 fshatra. Ne mëtojmë që të zgjerohemi edhe në 26 fshatra të cilët do të mbulohen me shërbimet tona. Kjo rritje do të jetë refleksion i zgjerimit të makinerive (kamionët e rinjë), të cilët do të ndikojnë edhe në rritjen e performancës së grumbullimit të mbeturinave dhe njëherit një gamë me gjerë e konsumatorëve të cilët do të inkuadrohen në bazën e të dhënave të KRM "ÇABRATI" Sh.A., Po ashtu, llogaritet që zgjerimi në këto zona do të ndodhë edhe me ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve komunale, (Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspeksionit), në shqiptimin e gjobave mandatore dhe masave tjera vetëdijësuese për qyetarët.

6.2. Implementimi i programit "ALFA BILLING" - KRM "ÇABRATI" Sh.A.

Sektori për Inkasim/Faturim dhe Marrëdhënieve me Konsumatorë, nga muaji qershor 2019, ka filluar implementimin e programit përmes së cilit kryen:

- Vendimet e duhura për pasqyra të sakta financiare;
- Menaxhim të saktë të të hyrave dhe pagesave në faturim dhe inkasim;
- Automatizimin e procesit të faturimit;
- Raportim të shpejtë dhe të mirëfilltë në Ndërmarrje dhe organet tjera relevante;
- BILLING - Sistem Faturimi për mbledhjen e pagesave.

7. TREGU I NAMAZGJAHUT

Është një aset i cili duhet që të funksionalizohet dhe të hyjë në përdorim në mënyrë që të krijojë të ardhura me qëllim të forcimit të kapaciteteve tona financiare. Duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet komunale gjegjësisht me Dejtorinë e Shërbimeve Publike, Kabinetin e Kryetarit,

Komisionin Komunal të Aksionarëve, KRM "ÇABRATI" Sh.A., do të ndërmarrë iniciativa të cilat si objektivë kanë ri-funksionalizimin e Tregut të Bylmetit dhe shfrytëzimin e platosë për parking të automjeteve me pagesë, hapësirë e cila do të jetë në funksion të qytetarëve të komunës së Gjakovës. Për më shumë, kjo do të jetë një vlerë e shtuar e angazhimeve të personelit të KRM "ÇABRATI" Sh.A.

8. SEKTORI JURIDIK DHE ADMINISTRATIVË

Hartimi, përgatitja dhe plotësim ndryshimi i legjislacionit për nevojat e ndërmarrjes konform ligjeve në fuqi, si dhe mbrojtja e interesave të ndërmarrjes nga palët e treta, gjithashtu edhe përgjegjja në kohë brenda afateve ligjore.

9. BURIMET NJERËZORE

KRM "ÇABRATI" Sh.A. Gjakovë, ka gjithsej 143 persona që marrin paga. Rritja ose zvogëlimi i personelit të ri do të bëhet në bazë të kërkesave në rritje për ofrimin e shërbimeve.

10. SEKTORI FINANCIAR

Gjendja Financiare

01.01 – 30.09.2019

Planifikimi Financiar

01.01 – 31.12.2020

KONTO	PERSHKRIMI	Shpenzimet:	Të Hyrat:	Shpenzimet:	Të Hyrat:
5101 0	SHPENZ.TE MATER.NDIHMES	13,381.16 €		16,057.39 €	- €
5121 0	SHPENZ.TE MATER. PER ZYRE	13,356.97 €		16,028.36 €	- €
5122 0	SHPENZ.TE MAT.PER MBAJTJEN E H	603.00 €		884.40 €	- €
5131 0	SHPENZ.TE ENERGJIS ELEK.	4,491.52 €		5,689.26 €	- €
5133 0	SHPENZ.E KARBURANTEVE PER AUTO	87,622.40 €		113,324.97 €	- €
5134 0	SHPENZ.E KARBURANTEVE-BENZINA	2,163.40 €		2,307.63 €	- €
5135 0	SHPENZ.VAJRAVE MOTORIKE	4,168.46 €		5,002.15 €	- €
5137 0	GAZI-PLINI	48.88 €		61.91 €	- €

5200 0	SHPENZ.TE PAGEFITIMEVE NETO	467,304.36 €		685,379.73 €	- €
5220 0	SHPENZ.PER TATIME MBI PAGEFITI	24,458.80 €		35,872.91 €	- €
5230 0	SHPENZ.PER KONTRIBUTE MBI PAGE	51,527.28 €		75,573.34 €	- €
5300 0	SHPENZ.TE SHPENZIMEVE TE NDERM	1,048.71 €		1,258.45 €	- €
5301 0	SHPENZ.PER SHERB.KOMUNALE	1,898.37 €		2,278.04 €	- €
5302 0	AUTOGOMA	8,917.03 €		10,700.44 €	- €
5310 0	SHPENZ.PER SHERBIME TE TELEKOM	2,879.42 €		3,455.30 €	- €
5320 0	SHPENZ.TE SHERBIMEVE TJERA TE	25,356.27 €		30,427.52 €	- €
5321 0	SHPENZ.MIREMB.OBJEKTIT	813.14 €		1,517.86 €	- €
5351 0	SHPENZ.TE REKLAMES E PROPAGAND	4,340.00 €		868.00 €	- €
5390 0	SHPENZ.TE SHERB.NGA TE TJERET	5,591.99 €		5,591.99 €	- €
53901 0	SHPENZ.E DEPONIS MBETURINAVE	79,818.18 €		95,781.82 €	- €
5500 0	SHPENZ.E UDHTIMEVE ZYRTARE(DIE	1,543.12 €		2,674.74 €	- €
5510 0	SHPENZ.PER REVISTE DHE PUBLIKI	1,501.72 €		1,501.72 €	- €
5520 0	SHPENZ.TE PERFAQSIMIT BRENDA V	5,434.56 €		6,521.47 €	- €
5530 0	PREMIT E SIGURIMIT	3,414.68 €		4,552.91 €	- €
5539 0	SHPENZ.TE TJERA PER PREMI	2,508.95 €		3,345.27 €	- €
5540 0	SHPENZ.TE QARKULLIMIT TE PAGES	623.63 €		748.36 €	- €
5550 0	ANETARESIT	- €		- €	- €
5560 0	TATIMI MBI PASURIN	549.12 €		658.94 €	- €
5562 0	TATIMI NE FITIM	2,730.93 €		3,277.12 €	- €
5590 0	SHPENZ.GJYGJSORE DHE SHPENZ.E	60.00 €		64.00 €	- €
5591 0	SHPENZ.SHERB.MJEKESORE	113.62 €		454.48 €	- €
5592 0	SHPENZIMET E PERMBARUESIT	208.00 €		249.60 €	- €
5799 0	TE DALA TE TJERA AFARISTE DHE	3,659.47 €		4,391.36 €	- €
611 0	TE HYRA NGA SHITJA E PROD.DHE		281,038.22 €	- €	412,189.39 €
6111 0	TE HYRA NGA SHITJA E SHERBIMEV		1,071.26 €	- €	1,571.18 €
6112 0	TE HYRAT NGA VARREZAT		28,310.90 €	- €	41,522.65 €
6114 0	REALIZIMI BIZNESI I VOGEL		97,977.39 €	- €	143,700.17 €
6115 0	REALIZIMI AMVISNIA		451,530.83 €	- €	662,245.22 €
6117 0	TE HYRAT NGA NDERT.VARREZAVE		1,296.33 €	- €	1,901.28 €
6402 0	TE HYRA NGA DONACIONET		109,668.20 €	- €	131,601.84 €
6609 0	TE HYRA TE TJERA FINANCIARE		9,837.51 €	- €	11,805.01 €
6730 0	TE HYRA NGA VITET E MEPARSHME		14,116.46 €	- €	22,586.34 €
Gjithsej:		822,137.14 €	994,847.10 €	1,136,501.45 €	1,429,123.09 €
Fitimi i pa sistemuar:		172,709.96 €		292,621.63 €	

11. PROJEKTET

- KRM "ÇABRATI" Sh.A., vazhdon me implementimin e projektit të bashkëpunimit ndërkuftar në mes të Malit të Zi dhe Kosovës në kuadër të Programit IPA 2014–2020 të Bashkimit Evropian.
- KRM "ÇABRATI" Sh.A., vazhdon implementimin e aktiviteteve në kuadër të projektit "Organizimi i pikave grumbulluese të mbeturinave dhe nisja e praktikimit të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim" të përkrahur nga GIZ dhe që realizohet nga organizta GAC - Prishtinë.
- Implementimi i projektit për "Zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në zonat rurale në regionin e Gjakovës". Qëllimi i projektit është përkrahja teknike për KRM "ÇABRATI" Sh.A., në paisje dhe makineri dhe njëherit organizimin e fushatës sensibilizuese dhe informuese me konsumatorët e viseve rurale në lidhje me mbledhjen e mbeturinave.
- KRM "ÇABRATI" Sh.A., ka dërguar letra interesimi për përkrahje tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë;
- KRM "ÇABRATI" Sh.A., do të aplikojë me projekt propozim tek Zyra Japoneze për makineri;
- KRM "ÇABRATI" Sh.A., do të aplikojë për gjetjen e lokacionit për Stacionin e Mbetjeve Inerte, ku parashikohet që të bëhet edhe grumbullimi dhe ndarja në burim të mbetjeve inerte;
- KRM "ÇABRATI" Sh.A., ka përgaditur projektin për Ndërtimin e Objektivit të Ri të Operativës dhe do të aplikojë për leje ndërtimi dhe mbështetje financiare tek organet kompetente lokale dhe qendrorë.

Aprovuar nga:

Nesrete Juniku



Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
K.R.M. "ÇABRATI" Sh.A.



Me datë: 30 tetor 2019